



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR
SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06
Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Për: Gjykatësin e Procedurës Paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon
Parashtrues: Prokurori i Specializuar
Data: 22 dhjetor 2020
Gjuha: Anglishte
Klasifikimi: Publik

**Versioni i redaktuar publik i përgjigjes së Prokurorisë ndaj kërkesës në emër të z.
Jakup Krasniqi për lirim të përkohshëm**

Prokurori i Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit
Dejvid Hupër

Mbrojtësit të Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

I. HYRJE

1. Kërkesa për lirimin e KRANIQIT¹ duhet të hidhet poshtë dhe z. KRASNIQI ('KRASNIQI') duhet të mbetet në paraburgim. Siç konstatohet në Vendimin për fletarrestimet,² janë përmbushur kriteret e paraburgimit të parapara në nenin 41(6) të Ligjit³. Këto kritere ende përmbushen dhe, siç diskutohet më poshtë, informacioni i zbuluar rishtazi vetëm sa nënvizon sa të rënda janë rreziqet e paraqitura. Asnjë masë alternative nuk është e mjaftueshme për të trajtuar këto rreziqe.

II. PARASHTRIMET

A. KORNIZA E ZBATUESHME LIGJORE NË KONTEKSTIN E DUHUR

2. Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të bindet⁴ se: (i) ekziston dyshim i bazuar se KRASNIQI ka kryer një vepër penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara ('DHSK'); dhe (ii) ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se: (1) ekziston rreziku i arratisjes; (2) KRASNIQI do të pengojë ecurinë e procedimit penal, ndër të tjera përmes ushtrimit të ndikimit mbi dëshmitarët, viktimat, ose bashkëkryesit; ose (3) natyra e rëndë e veprës penale, ose mënyra apo rrethanat e kryerjes së saj dhe karakteristikat personale të KRASNIQIT, sjellja e tij në të kaluarën, mjedisi dhe kushtet në të cilat jeton, ose rrethanat e tjera personale, janë tregues të

¹ Kërkesë për lirim të përkohshëm, KSC-BC-2020-06/F00122, 7 dhjetor 2020, konfidenciale (me tre shtojca) ("Kërkesa për lirimin e KRASNIQIT").

² Vendim mbi kërkesën për fletarrestime dhe urdhra transferimi, KSC-BC-2020-06/F00027, 26 tetor 2020 ("Vendimi mbi fletarrestimet"). *Shih edhe* Version i redaktuar konfidencial i "Kërkesës për fletarrestime dhe urdhra në lidhje me to", KSC-BC-2020-06/F00005, 28 maj 2020, KSC-BC-2020-06/F00005/CONF/RED, 15 nëntor 2020 ("Kërkesa për fletarrestime").

³ Ligji Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, 3 gusht 2015 ("Ligji"). Përveç nëse nuk specifikohet ndryshe, të gjitha referencat për neni/nenet janë në lidhje me Ligjin.

⁴ Vendim mbi apelimin e Hysni Gucatit për çështje të lidhura me arrestimin dhe mbajtjen e tij në paraburgim, KSC-BC-2020-07/IA001/F00005, 9 dhjetor 2020, publik, ("Vendimi i apelit"), para. 51.

rrezikut se ai do të përsërisë veprën penale, do të përfundojë një vepër penale të tentuar, ose do të kryejë një vepër penale që ka kërcënuar se do ta kryejë.⁵

3. Nuk ka kritere të tjera përveç atyre të përcaktuara në Ligj; propozimi i standardeve shtesë ose të ndryshme nuk e avancon çështjen.⁶ Ajo çfarë kërkohet është që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të bindet se përmbushen kriteret e përcaktuara në nenin 41(6)(b). Nëse bindet, KRASNIQI do të vazhdojë të mbahet në paraburgim.⁷

4. Mbrojtja e KRASNIQIT mbështetet në formulimin e nenit 41(6),⁸ por interpretimi i tij është i paplotë. Megjithëse Ligji përfshin fjalët “është” dhe “do të” kur përshkruan kriteret e nenit 41(6), këto fjalë janë pjesë e një formulimi që e bën të qartë se nuk kërkohet aspak të qenit plotësisht i sigurt. Nuk është e nevojshme që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të arrijë në përfundimin se KRASNIQI “do të” pengojë hetimin, por thjesht se “ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar” se kjo mund të ndodhë. Po kështu, nuk është e nevojshme të vërtetohet se KRASNIQI “do të arratiset” ose “do të kryejë” krime të tjera, por thjesht se ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se ekziston rreziku që këto të ndodhin. Sikurse është konfirmuar së fundmi nga Gjykata e Apelit, ajo që duhet të vlerësohet është mundësia, e jo pashmangshmëria e ndodhjes së ngjarjeve të tilla në të ardhmen.⁹

5. Më 26 tetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se përmbushen kriteret e parapara në nenin 41(6) dhe se paraburgimi i KRASNIQIT është i

⁵ Neni 41(6)(b)(i)-(iii).

⁶ *Contra* Kërkesa për lirim të KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/F00122, para. 30 (formulimi i nenit 41(6)(b) “sugjeron që duhet të përcaktohet një standard i lartë i provës, që kërkon më shumë sesa thjesht ekzistencën e mundësisë”).

⁷ Vendim mbi apelin e Hysni Gucatit për çështje të lidhura me arrestimin dhe mbajtjen e tij në paraburgim, KSC-BC-2020-07/IA001/F00005, 9 dhjetor 2020, publik, (“Vendimi i apelit”), para. 51.

⁸ Kërkesa për lirim të KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/F00122, para. 30.

⁹ Vendimi i apelit, KSC-BC-2020-07/IA001/F00005, para. 67; Vendimi mbi fletarrestimet, para. 27.

domosdoshëm. Në bazë të Kërkesës për lirimin e KRASNIQIT dhe Rregullës 57(2),¹⁰ ajo që duhet shqyrtuar tani është rishikimi i atij vendimi.¹¹

B. JANË VËRTETUAR RREZIQET E PARAPARA NË NENIN 41(6)

6. Për arsyet e parashtruara në Vendimin e konfirmimit,¹² ekziston dyshim i bazuar mirë se KRASNIQI ka kryer më shumë krime që bien brenda juridiksionit të DHSK-së.

7. Për më tepër, ndonëse mjafton prania e vetëm njërit prej tyre, të tre rreziqet e parapara në nenin 41(6)(b) janë të pranishme dhe asnjë kusht nuk i zvogëlon ato në masë të mjaftueshme. Përpjekjet e Mbrojtjes së KRASNIQIT për të cenuar arsyet e pretenduara në Kërkesën për fletarrestime duke u mbështetur kryesisht në përkushtimin e KRASNIQIT ndaj Kosovës dhe statusin e tij si person i pensionuar, janë të mangëta dhe jobindëse. Të marra së bashku, provat e paraqitura demonstrojnë qartë rreziqet e konsiderueshme po qe se Jakup KRASNIQI do të lirohej.

8. Në lidhje me vetë rreziqet, paraprakisht duhet të trajtohen dy aspekte të tjera.

9. Së pari, Mbrojtja e KRASNIQIT pretendon se data e fillimit të gjyqimit është një faktor i rëndësishëm gjatë shqyrtimit të lirimimit të përkohshëm.¹³ Megjithatë, Mbrojtja e KRASNIQIT nuk bën asnjë përpjekje për të lidhur rreziqet e parapara në nenin 41(6)(b) me vlerësimin e saj të kohëzgjatjes së paraburgimit në pritje të gjyqimit. Në

¹⁰ Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev3/2020, 2 qershor 2020 ("Rregullorja"). Përveç nëse nuk specifikohet ndryshe, të gjitha referencat për rregulla/rregullat janë në lidhje me Rregulloren.

¹¹ *Shih për ngjashmëri*, Vendimi i apelit, KSC-BC-2020-07/IA001/F00005, para. 37-38.

¹² Vendim për konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, KSC-BC-2020-06/F00026, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* ("Vendimi i konfirmimit").

¹³ Kërkesa për lirim e KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/F00122, para. 15-16, 18.

vend të kësaj, vlerësimi i kohëzgjatjes së paraburgimit prezantohet si justifikim i saj i pavarur për lirim.

10. Rivlerësimi dhe rishikimi aktual i masës së paraburgimit është në përputhje me rregullën 57. Një dispozitë tjetër, përkatësisht rregulla 56(2), parashikon mundësinë e lirit të një të akuzuari nëse ai mbahet në paraburgim për një periudhë të paarsyeshme para hapjes së çështjes. Do të ishte e pabazë për Mbrojtjen e KRASNIQIT që të pretendonte lirim në bazë të rregullës 56(2) kur i akuzuari është arrestuar vetëm një muaj më parë, dhe ajo nuk përpiqet ta bëjë këtë gjë. Mbrojtja e KRASNIQIT ka parashtruar argumentet e veta në lidhje me kohëzgjatjen e pritshme të procedurës paraprake në këtë çështje dhe ZPS-ja ka shpjeguar pse i konsideron ato të paarsyeshme.¹⁴ Gjithsesi, zgjidhja e kësaj pike të kontestueshme nuk ndikon aspak në çështjet aktualisht për shqyrtim para Gjykatësit të Procedurës Paraprake, veçanërisht në rrethana kur korniza ligjore parashikon rivlerësimin dhe rishikimin e masës së paraburgimit çdo dy muaj.¹⁵

11. Së dyti, Mbrojtja e KRASNIQIT i kundërshton faktorët mbështetës si të papajtueshëm me një vlerësim të individualizuar të rreziqeve që paraqet i akuzuari.¹⁶ Argumente të tilla rrjedhin nga një pikënisje e gabuar, përkatësisht se provat në lidhje me kontekstin ose veprimet e të tjerëve nuk mund të shërbejnë si bazë për vlerësimin e duhur dhe të individualizuar të rreziqeve që paraqet një i akuzuar. Përkundrazi, pozita ose kontaktet e një të akuzuari mund të merren parasysh gjatë përcaktimit të gjasës së kthimit të tij për gjykim, kërcënimit të dëshmitarëve nëse lirohet, ose kryerjes së krimeve të tjera.¹⁷ Rrjetet e gjera dhe aktive të përkrahjes mund po ashtu të rrisin

¹⁴ Parashtrime të Prokurorisë pas konferencës së 18 nëntorit 2020 mbi ecurinë e çështjes, KSC-BC-2020-06/F00097, 23 nëntor 2020.

¹⁵ Rregulla 57(2).

¹⁶ Kërkesa për lirim të KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/F00122, para. 31, 43, 49.

¹⁷ Vendimi i apelit, KSC-BC-2020-07/IA001/F00005, para. 63 (ku nuk konstatohet asnjë gabim sa i takon mbështetjes në pozitën e një personi si tregues i kontakteve dhe rrjetit që "mund të krijojë rrezikun se KSC-BC-2020-06

rrezikun që i akuzuari të përdorë kapacitetet e një rrjeti përkrahësish për t'u arratisur.¹⁸ Në lidhje me këtë, kur rrethana të përbashkëta vlejné për më shumë të akuzuar, shqyrtimi i këtyre rrethanave së bashku, siç është bërë, sipas rastit, në Kërkesën për fletarrestime dhe Vendimin mbi fletarrestimet, është përputhës me një vlerësim të individualizuar.

12. Rreziku që përbën një i akuzuar mund të rritet për shkak të veprimeve të tij personale ose rrethanave të barasvlershme për të dhe për të gjithë të bashkakuzuarit e tjerë. Në veçanti, sikurse e pranon edhe vetë Mbrojtja e KRANIQIT,¹⁹ problemi i frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë është faktor i rëndësishëm që duhet mbajtur parasysh gjatë vlerësimit në lidhje me vazhdimin e paraburgimit.²⁰ Kjo atmosferë e vazhdueshme e frikësimit të dëshmitarëve, edhe pse pa dyshim tejet shqetësuese, gjithsesi nuk është e vetmja rrethanë që pretendohet në mbështetje të paraburgimit të KRASNIQIT.

1. Rreziku i arratisjes

13. Është konstatuar se ekziston rreziku i arratisjes për shkak se: (a) vendimet për fajësi penale të ish-anëtarëve të lartë të UÇK-së në çështje gjyqësore të tjera krijojnë motiv për arratisje; (b) postet që ka mbajtur KRASNIQI në të kaluarën mundësojnë mobilizimin e përkrahësve të tij; (c) KRASNIQI ka qasje në fonde të konsiderueshme; (d) KRASNIQI ka mundësinë të udhëtojë lirisht në juridiksione që nuk kanë detyrimin

z. Gucati mund të pengojë procesin ose mund të kryejë vepra penale të tjera"); ICC/GJPN, *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-824, Judgment on the Appeal of Mr. Lubanga Dyilo Against the Decision of Pre-Trial Chamber 1 Entitled "Decision sur la demande de mise en liberte provisoire de Thomas Lubanga Dyilo", 13 shkurt 2007, para. 136-37.

¹⁸ ICC/GJPN, *Prosecutor v. Gbagbo*, ICC-02/11-01/11-180-Red, Decision on the "Requête de la Défense demandant la mise en liberte provisoire du président Gbagbo", 13 korrik 2012, para. 62.

¹⁹ Kërkesa për lirim të KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/F00122, para. 44.

²⁰ Kërkesa për lirim të KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/F00122, para. 44.

e transferimit të tij; dhe (e) motivi i KRASNIQIT për t'u arratisur do të bëhej më i fortë pasi të informohej për akuzat e konfirmuara.²¹ .

14. KRASNIQI akuzohet për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit në lidhje me mbi 40 qendra ndalimi, përfshirë edhe për vrasje të paligjshme dhe torturë. Krimet për të cilat akuzohet KRASNIQI mund të përfshijnë edhe dënim me burgim të përjetshëm.²² Kjo mundësi shkakton një rrezik të vazhdueshëm të arratisjes, i cili vetëm sa do të jetë edhe më i madh kur KRASNIQI të informohet për tërësinë e provave kundër tij.²³ Siç është theksuar së fundmi nga Gjykata e Apelit: “natyra e veprës penale si dhe ashpërsia e dënimit janë faktorë të rëndësishëm për t'u marrë parasysh gjatë marrjes së vendimit nëse paraburgimi është i domosdoshëm në rrethanat e një çështjeje specifike.”²⁴ Edhe Dhoma e Madhe e GJEDNJ-së i njeh këta faktorë si të rëndësishëm për vlerësimin e rrezikut të arratisjes së një të akuzuari,²⁵ dhe ka gjykuar se këta faktorë janë sidomos me rëndësi në çështje gjyqësore ku pretendohen krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, sikurse çështja në fjalë.²⁶

15. Është jobindës argumenti i KRASNIQIT se fakti që ka kaluar një dekadë në burg do të thotë se dënimi i mundshëm me burgim të përjetshëm “nuk e frikëson atë”.²⁷ Pohimeve hipotetike të këtij lloji nuk duhet t'u jepet rëndësi. Ky argument i KRASNIQIT mund të përdoret për të argumentuar edhe të kundërtën, përkatësisht se

²¹ Vendimi mbi fletarrestimet, KSC-BC-2020-06/F00027, para. 28. *Shih gjithashtu* Kërkesa për fletarrestime, KSC-BC-2020-06/F00005, para. 31-33 (përfshirë përmes referencave).

²² Neni 44(1).

²³ Vendimi mbi fletarrestimet, KSC-BC-2020-06/F00027, para. 28.

²⁴ Vendimi i apelit, KSC-BC-2020-07/IA001/F00005, para. 72.

²⁵ ECtHR/GJEDNJ (Grand Chamber/Dhoma e Madhe), *Idalov v. Russia*, 5826/03, 22 maj 2012, para. 145.

²⁶ GJEDNJ-ja ka konstatuar se, në çështjet gjyqësore që kanë të bëjnë me krime lufte kundër popullatës civile, paraburgimi mund të përligjet dhe zgjatet vetëm në bazë të asaj se sa të rënda janë akuzat, duke i kushtuar rëndësi të veçantë peshës së krimit në fjalë, llojit të akuzave dhe sa të rënda janë ato. *Shih* ECtHR/GJEDNJ, *Šuput v. Croatia*, 49905/07, Judgement, 31 maj 2011, para. 101-110; ECtHR, *Getoš-Magdić v. Croatia*, 56305/08, Judgement, 2 dhjetor 2010, para. 80-91

²⁷ Kërkesa për lirimin e KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/F00122, para. 39.

rreziku i arratisjes së tij është më i madh për shkak të burgimit të tij të mëparshëm, sepse ai do t'i ikte burgimit për herë të dytë, e këtë herë ndoshta përgjithmonë.

16. Mosha dhe lidhjet e KRASNIQIT me Kosovën²⁸ nuk e ndryshojnë realitetin se, si institucion kosovar, DHSK-ja mund të kërkojë bashkëpunimin e detyrueshëm për dorëzimin e KRASNIQIT vetëm nga Kosova ose nga një vend që e njeh Kosovën dhe që ka marrëveshje ekstradimi me të ose ndonjë legjislacion tjetër mundësues.²⁹ Marrëveshje të tilla ka vetëm me një numër të kufizuar vendesh.³⁰ Kjo situatë dallon ndjeshëm nga juridiksione të tjera dhe institucione të tjera, siç ishte TPNJ-ja, që mund të kërkonte bashkëpunim më të zgjeruar të detyrueshëm në bazë të kompetencave që ia jepte Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara.³¹ KRASNIQI mund të udhëtojë në mbi 180 vende të botës, për t'iu larguar kështu në mënyrë të përhershme mundësisë për t'u kapur nga DHSK-ja.

17. Mbrojtja e KRASNIQIT dukshëm nënvlerëson ndikimin e KRASNIQIT në Kosovë, duke u orvatur ta paraqesë atë si një njeri në pension, të lidhur me një parti të "vogël" politike.³² Jakup KRASNIQI është ish-Kryetari i Kuvendit të Kosovës dhe ish-ushtresë i detyrës së Presidentit të Kosovës. Ai është gjithashtu ish-Zëvendëskomandanti i UÇK-së. Një jetë e tërë kontaktesh me UÇK-në dhe qeverinë nuk harrohen thjesht me dalje në pension. Sikurse të akuzuarit e tjerë në këtë çështje, edhe KRASNIQI ka qasje tek i njëjti rrjet i gjerë përkrahësish, që përfshin edhe persona me përvojë në lëmin e sigurisë, policisë dhe inteligjencës. Ky rrjet është qartazi i aftë

²⁸ Kërkesa për lirim të KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/F00122, para. 4, 33.

²⁹ Neni 55(2); Rregulla 208.

³⁰ Këtu përfshihen Shqipëria, Austria, Belgjika, Kroacia, Republika Çeke, Gjermania, Hungaria, Italia, Maqedonia, Turqia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara. Shumica e këtyre vendeve kanë lidhur marrëveshje ekstradimi me vetë Kosovën. Vende të tjera kanë rënë dakord zyrtarisht me Kosovën për vijimin e zbatimit të marrëveshjeve të ekstradimit të lidhura me Republikën Federale të Jugosllavisë.

³¹ Këshilli i Sigurimit i OKB-së, S/RES/827 (1993), Rezoluta 827, 25 maj 1993, para.4.

³² Kërkesa për lirim të KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/F00122, para. 5, 40, 50.

për ta fshehur KRASNIQIN brenda territorit të Kosovës, ose për të mundësuar arratisjen e tij në një shtet tjetër.

18. Argumenti se KRASNIQI nuk u arratis nga Kosova në periudha të mëparshme të jetës së tij, kur e dinte se mund të burgosej, nuk meriton shumë peshë në këtë analizë.³³ Mundësia dhe motivi i KRASNIQIT për t'u arratisur duhet të vlerësohen në kontekstin e mundësive aktualisht të disponueshme për të si një drejtues i lartë i UÇK-së dhe politikan i suksesshëm. Se KRASNIQI nuk u arratis në periudha të jetës së tij kur arratisja ishte më e vështirë,³⁴ nuk është një masë e saktë për vlerësimin e rrezikut aktual.

19. Mbrojtja e KRASNIQIT parashtron se nuk janë paraqitur prova në lidhje me fondet e konsiderueshme të tij,³⁵ dhe vetëm disa faqe më pas parashtron se ai e kalon kohën në dy shtëpi të ndryshme.³⁶ Problem më i madh janë fondet që mund t'i vihen në dispozicion KRASNIQIT nga rrjeti i gjerë i përkrahësve. Fakti që KRASNIQI përqendrohet në pasurinë vetjake zbeh realitetin që KRASNIQI ka *qasje* në fonde të konsiderueshme.

20. Dëshmia e KRASNIQIT kur është thirrur në çështje gjyqësore të mëparshme dhe paraqitja vullnetare e tij për intervistë me ZPS-në nuk e eliminojnë rrezikun e arratisjes,³⁷ dhe Gjykatësi i Procedurës Paraprake i kishte në dispozicion këto fakte kur mori Vendimin mbi fletarrestimet.

2. Rreziku i pengimit të hetimit

³³ Kërkesa për lirimin e KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/F00122, para.34.

³⁴ Për të paktën 10 vjet të jetës së tij, arratisja ishte e pamundur. Paragrafi 15 më lart.

³⁵ Kërkesa për lirimin e KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/F00122, para.41.

³⁶ Kërkesa për lirimin e KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/F00122, para.6.

³⁷ *Contra* Kërkesa për lirimin e KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/F00122, para. 7-8, 37-38.

21. Është konstatuar se ekziston rreziku i pengimit të hetimit për shkak se: (a) postet që ka mbajtur KRASNIQI në të kaluarën i mundësojnë atij të mobilizojë lehtësisht një rrjet të gjerë përkrahësish; (b) KRASNIQI ka sulmuar publikisht DHSK-në dhe është orvatur ta delegjtimojë atë; dhe (c) në Kosovë ekziston një atmosferë e përgjithshme e frikësimit të dëshmitarëve që dëshmojnë kundër pjesëtarëve të UÇK-së.³⁸ Siç përshkruhet më poshtë, janë zbuluar faktorë të tjerë që mbështesin praninë e këtij rreziku.

(a) Deklaratat dhe veprimet

22. Mbrojtja e KRASNIQIT pretendon se komentet e shumta publike të tij që kundërshtojnë krijimin e DHSK-së, kritikojnë veprimtarinë e saj, apo i quajnë ndjekjet penale të anëtarëve të UÇK-së si absurde, janë opinione politike, të cilat ai ka të drejtë t'i shprehë lirisht. Por, nëse ato janë shprehje e opinioneve politike të tij apo jo, është përtej diskutimit. Ato janë të rëndësishme për vlerësimin e rrezikut se KRASNIQI do të përpiqet të pengojë administrimin e drejtësisë apo të ndërhyjë ndaj dëshmitarëve. Të marra së bashku, nëse asgjë tjetër, ato vërtetojnë se KRASNIQI beson se DHSK-ja është një kërcënim i padrejtë ndaj trashëgimisë së UÇK-së. Natyrisht që provat në mbështetje të gjasës se KRASNIQI do të pengojë administrimin e drejtësisë apo se do të ndërhyjë ndaj dëshmitarëve, tejkalojnë sulmet e përsëritura të tij ndaj DHSK-së.

23. Së pari, thelbi i ndërmarrjes kriminale të përbashkët në këtë çështje gjyqësore është shënjestrimi i kundërshtarëve të UÇK-së, të përkufizuar në Aktakuzën e Konfirmuar si persona që ishin, ose që konsideroheshin se kishin qenë bashkëpunëtorë apo të lidhur me armiq të UÇK-së, ose që ndryshe nuk mbështetnin qëllimet ose metodat e udhëheqjes së UÇK-së.³⁹ Si zëdhënës i UÇK-së dhe

³⁸ Vendimi mbi fletarrestimet, KSC-BC-2020-06/F00027, para. 41. *Shih gjithashtu* Kërkesa për fletarrestime, KSC-BC-2020-06/F00005, para. 34-38 (përfshirë përmes referencave).

³⁹ Aktakuza e konfirmuar, KSC-BC-2020-06/F00034/A01, 30 tetor 2020, para. 32.

Zëvendëskomandant i Përgjithshëm, KRASNIQI ishte një nga arkitektët kryesor të atij qëllimi të përbashkët. KRASNIQI ka dhënë intervista të ndryshme si zëdhënës, duke përfaqësuar Shtabin e Përgjithshëm, ndër të cilat edhe intervista e korrikut 1998, ku ndërsa shprehet për UÇK-në se “te ne kidnapime nuk ka”, ai pranon se “edhe në qoftë se kanë pësuar disa, më tepër janë kolaboracionistë shqiptarë se sa civilë serbë”, duke shtuar se “[ç]farë kemi pasur të kidnapuar, ose e japim listën ose e bëjmë të ditur nëse ekzekutohet, por në mënyrë të poshtër si Serbia nuk e bëjmë”.⁴⁰ Duke bërë thirrje për ndëshkimin e bashkëpunëtorëve, KRASNIQI i dha zë ndërmarrjes kriminale të përbashkët dhe deklaratat e tij të mëpasshme duhet të kuptohen në këtë kontekst.

24. Në një postim në Facebook më pak se tetë muaj më parë, KRASNIQI e quajti Shkëlzen Gashin “kolaboracionist” pse kishte guxuar të deklaronte publikisht se pjesëtarë të UÇK-së kishin kryer krime, duke e bërë kështu GASHIN objekt të kërcënimeve me vdekje dhe duke konfirmuar se pikëpamjet e KRASNIQIT në lidhje me shënjestrimin e atyre që perceptohen si bashkëpunëtorë, kanë mbetur të pandryshuara.

25. Mbrojtja e KRASNIQIT përpiqet të nënvlerësojë rëndësinë e postimit në Facebook me një sërë argumentesh jobindëse.⁴¹ Ajo pretendon se postimi nuk “bën thirrje që ndonjë individ të ndërhyjë ndaj dëshmitarëve, bashkëkryesve, ose viktimave”. Megjithatë, pretendimi se KRASNIQI nuk po bënte thirrje për veprim mund të argumentohet vetëm duke anashkaluar një mal me prova që janë aktualisht para kësaj gjykate lidhur me kuptimin e etiketimit të dikujt si “bashkëpunëtor”, për të mos përmendur deklarin e tyre si persona “në shërbim të politikës gjenocidale të MILLOSHEVIQIT”. Mbrojtja e KRASNIQIT më tej pretendon se “nuk ka prova që e lidhin në mënyrë të drejtpërdrejtë këtë postim me z. Gashi”, por koha e postimit

⁴⁰ Intervistë e Jakup KRASNIQIT, Koha Ditore, U003-8586-U003-8590, f. U003-8589.

⁴¹ Kërkesa për lirimin e KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/F00122, para. 47.

(postimi i KRASNIQIT u bë në të njëjtën ditë me komentet e z. GASHI), si dhe konteksti - përfshirë edhe përmendja nga KRASNIQI e çdo personi “që është në shërbim të kryeministrit, ose në çfarëdo pozite tjetër” (një *non sequitur* me plotë kuptimin e fjalës nëse nuk i referohej GASHIT, i cili asokohe punonte për Kryeministrin e atëhershëm) - konfirmon pa mëdyshje se z. GASHI ishte ndër ata që u shënjestruan specifikisht nga KRASNIQI. Në fund, Mbrojtja e KRASNIQIT pretendon se “nuk ka prova [...] se z. Gashi ishte viktimë ose dëshmitar, apo i lidhur në ndonjë mënyrë tjetër me procedurat e DHSK-së,” sikur realisht nxitja e kërcënimeve me vdekje ndaj personave ka rëndësi vetëm për qëllime të paraburgimit në qoftë se këta persona lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me DHSK-në. Sikurse theksohet në kërkesën e ZPS-së,⁴² shembulli i GASHIT pasqyron një atmosferë mosndëshkimi dhe frikësimi që KRASNIQI dhe të bashkakupuarit e tjerë kanë mundësuar dhe inkurajuar në mënyrë aktive.

26. Disa materiale të mbledhura rishtazi hedhin më shumë dritë mbi mendësinë e KRASNIQIT. [REDAKTUAR].⁴³ [REDAKTUAR]. [REDAKTUAR] [REDAKTUAR].

27. [REDAKTUAR]:⁴⁴

[REDAKTUAR]. [REDAKTUAR].⁴⁵

28. [REDAKTUAR],⁴⁶ [REDAKTUAR].

29. Kjo provë më vete lidhur me KRASNIQIN qartë tejkalon mbështetjen vetëm tek atmosfera e përgjithshme e frikësimit si përligjeje e vazhdimit të mbajtjes së tij në paraburgim. Vetë deklaratat dhe veprimet e tij në kohën e kryerjes së veprimeve për

⁴² Kërkesa për fletarrestime, KSC-BC-2020-06/F00005, para. 6.

⁴³ [REDAKTUAR].

⁴⁴ [REDAKTUAR].

⁴⁵ [REDAKTUAR].

⁴⁶ *Shih* Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës në emër të z. Rexhep Selimi për lirim të përkohshëm, 17 dhjetor 2020.

të cilat akuzohet, kohëve të fundit dhe ndërmjet këtyre dy periudhave, konfirmojnë se jo vetëm që është i gatshëm të shfrytëzojë rrethanat e atmosferës së lartpërmendur, por edhe se është në një masë domethënëse përgjegjës për të.

(b) Rrjeti mbështetës dhe atmosfera e frikësimit

30. Në shtator të vitit 2020, paketa materiale në lidhje me SITF/ZPS-në iu dorëzuan në mënyrë të paautorizuar Organizatës së Veteranëve të Luftës të UÇK-së ("OVL-UÇK"), të cilat ajo më tej i shpërndau ose i bëri publike. Ekzistojnë prova se dorëzimi i këtyre dokumenteve ishte pjesë e një fushate për frikësimin e dëshmitarëve, dhe kryetari dhe nënkryetari i OVL-UÇK-së u arrestuan pas kësaj për shkelje të fshehtësisë së procedurës dhe për frikësim/hakmarrje ndaj dëshmitarëve të mundshëm.⁴⁷

31. Që prej shumë kohësh, OVL-UÇK-ja ka një rrjet veçanërisht aktiv përkrahësish të cilët janë armiqësor ndaj punës hetimore të ZPS-së.⁴⁸ Ekziston rrezik i konsiderueshëm që OVL-UÇK-ja dhe të tjerë do të vijojnë me veprimtari të tilla, dhe një burim kryesor i mundshëm i rrjedhjes së informacionit është materiali që do t'i nxirret të akuzuarit. Ajo çfarë ka bërë tashmë OVL-UÇK-ja ka shkaktuar frikë tek shumë nga dëshmitarët e mundshëm të ZPS-së. Veprime të tilla demonstronjë edhe një herë se zhvillimi i proceseve ligjore në Hagë apo ofrimi i një programi gjithëpërfshirës për mbrojtjen e dëshmitarëve është më së miri të mos shihen si një zgjidhje ideale për zvogëlimin e rreziqeve të ndërhyrjes, por më tepër si një pasqyrim konkret i rëndësisë së jashtëzakonshme të problemit.⁴⁹

⁴⁷ *Shih në përgjithësi Prokurori kundër Gucatit dhe Haradinajt*, Aktakuza e redaktuar, KSC-BC-2020-07/F00075, 14 dhjetor 2020 (konfirmuar më 11 dhjetor 2020).

⁴⁸ Kërkesa për fletarrestime, KSC-BC-2020-06/F00005, para. 4-5.

⁴⁹ *Shih* *Obstructing the Investigation – Too Many Obstacles, Too Little Evidence*, Sense Agency, ICTY: The Kosovo Case, 1998-1999, gjendet në <https://kosovo.sense-agency.com/>; Kërkesa për fletarrestime, KSC-BC-2020-06/F00005, para. 21-22.

32. Përmes rolit të tij si udhëheqës i lartë i UÇK-së në të kaluarën, dhe në fakt si Zëvendëskomandant i UÇK-së, Jakup KRASNIQI është në një pozitë për të ushtruar ndikim të veçantë mbi këtë rrjet.⁵⁰

3. Rreziku i kryerjes së krimeve të tjera

33. Është konstatuar se ekziston rreziku i kryerjes së krimeve të tjera për shkak të: (a) natyrës së akuzës përkatëse për ndërmarrje kriminale të përbashkët kundër kundërshtarëve të të akuzuarit; (b) KRASNIQI ka sulmuar publikisht DHSK-në dhe është orvatur ta delegjitimojë atë; dhe (c) në Kosovë ekziston një atmosferë e përgjithshme e frikësimit të dëshmitarëve që dëshmojnë kundër pjesëtarëve të UÇK-së.⁵¹

34. Në lidhje me nenin 41(6)(b)(iii), KRASNIQI parashton se “përsëritja e veprës penale” duhet të interpretohet në mënyrë që të mbartë me vete elementët kontekstualë të krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit.⁵² Por, duhet të ishte e qartë për hartuesit se çdo konflikt i armatosur ose sulm kundër popullatës civile nga periudha juridiksionale do të kishte përfunduar deri në kohën e arrestimit të një të akuzuari rreth 15-20 vjet më vonë. Interpretimi më logjik i kësaj dispozite është se duhet të ekzistojë rreziku i përsëritjes së krimeve bazë nga i akuzuari. Në rastin aktual, ato përfshijnë vrasje të paligjshme, torturë dhe trajtim mizor dhe rrjedhimisht, përfundimi se “ekziston rreziku se z. KRASNIQI mund të përdorë dhunën fizike ose kërcënimin me dhunë fizike kundër atyre që perceptohen si kundërshtarë të UÇK-së, ndër të cilët

⁵⁰ *Contra* Kërkesa për lirim të KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/F00122, para. 40.

⁵¹ Vendimi mbi fletarrestimet, KSC-BC-2020-06/F00027, para. 42. *Shih gjithashtu* Kërkesa për fletarrestime, KSC-BC-2020-06/F00005, para. 40 (përfshirë përmes referencave).

⁵² Kërkesa për lirim të KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/F00122, para. 51.

viktimat dhe dëshmitarët',⁵³ është plotësisht brenda fushëveprimit të nenit 41(6)(b)(iii).⁵⁴

35. Thelbi i ndërmarrjes kriminale të përbashkët në këtë çështje gjyqësore është shënjestrimi i personave të perceptuar si kundërshtarë të UÇK-së.⁵⁵ Pavarësisht se KRASNIQI insistonte në atë kohë se "si ushtri, ne [UÇK-ja] i respektojmë të gjitha rregullat ndërkombëtare të luftës", ai gjithashtu pohoi se "bashkëpunëtorët janë paralajmëruar se do t'i vrasim nëse vazhdojnë në rrugën e gabuar".⁵⁶ Për këta ish-udhëheqës të UÇK-së, këto metoda vazhdojnë të ekzistojnë.⁵⁷

36. Mbrojtja e KRASNIQIT përpiqet të mbështetet në faktin se shkeljet e pretenduara janë kryer para 20 vjetësh, si një faktor që duhet të merret parasysh.⁵⁸ Fakti që ekziston dyshim i bazuar mirë se KRASNIQI ka kryer krime të luftës dhe krime kundër njerëzimit të ndryshme,⁵⁹ është një tregues i rëndësishëm, ndërmjet të tjerash i rrezikut se ai është i gatshëm të kryejë vepra të tjera të dhunshme, madje edhe shumë vite më pas.

⁵³ Vendimi mbi fletarrestimet, para. 42.

⁵⁴ *Shih* Kërkesa për fletarrestime, KSC-BC-2020-06/F00005/CONF/RED, para. 40.

⁵⁵ Aktakuza e konfirmuar, KSC-BC-2020-06/F00034/A01, 30 tetor 2020, para. 32.

⁵⁶ Intervistë e Jakup KRASNIQIT, qershor 1998, *Der Spiegel*, 043619-043620-ET, f. 3 (secili citim shfaqet në fjali njëra pas tjetrës).

⁵⁷ Për të përmendur një shembull të rëndësishëm nga viti 2020 që ka të bëjë me ish-komandantin e UÇK-së Sami LUSHTAKUN: më 11 prill 2020, avokati Gazmend HALILAJ postoi në Facebook se Sami LUSHTAKU qëndron pas shpërdorimit të 1,4 milionë markave gjermane gjatë luftës. LUSHTAKU pastaj telefonoi HALILAJN dhe i tha që ta hiqte postimin, duke e sharë dhe kërcënuar. Tri ditë më pas, me synimin e hakmarrjes për Sami LUSHTAKUN, kushëriri i tij Ibrahim LUSHTAKU dhe Xhelal ZEQRIRI pretendohet se kryen përplasje me veturën e HALILAJT pasdreken e 14 prillit 2020 dhe pastaj shtinë në drejtim të HALILAJT teksa ky po largohej nga vetura. Atë nuk e kapën plumbat. Sami LUSHTAKU pranoi fajësinë për veprën penale të ngacmimit kundër HALILAJT më 28 tetor 2020 dhe u dënua me gjobë prej 2000 eurosh. Ibrahim LUSHTAKU dhe Xhelal ZEQRIRI janë akuzuar për tentim për vrasje dhe çështja kundër tyre ende nuk ka përfunduar. Shtojca 1 e Përgjigjes së Prokurorisë ndaj kërkesës në emër të z. Hashim Thaçi për lirim të përkohshëm, KSC-BC-2020-06/F00149/A01, 16 dhjetor 2020.

⁵⁸ Kërkesa për lirim të HALILAJT, KSC-BC-2020-06/F00122, para. 50.

⁵⁹ Vendimi i konfirmimit, KSC-BC-2020-06/F00026, para. 474, 478, 482, 491.

C. ASNJË KUSHT NUK I ZVOGËLON MJAFTUESHËM KËTO RREZIQE

37. Mbrojtja e KRASNIQIT paraqet një listë kushtesh që mund të zbatohen në rast të lirimit të tij.⁶⁰ Asnjë kombinim i kushteve të propozuara nuk zvogëlon në asnjë masë rreziqet e shumta që paraqet KRASNIQI në rast të lirimit të tij.⁶¹ Paraburgimi është e vetmja masë përmes së cilës mund të menaxhohen në mënyrë të përshtatshme këto rreziqe, ku veçanërisht e rëndësishme është korniza e monitorimit të komunikimeve e Njësisë së Paraburgimit të DHSK-së, për të siguruar që asnjë informacion konfidencial që i zbulohet KRASNIQIT të mos shpërndalet në botën e jashtme.⁶² [REDAKTUAR].⁶³

38. DHSK/ZPS-ja nuk kanë kapacitete për monitorimin e duhur të të akuzuarve të liruar përkohësisht në Kosovë. Për më tepër, mandati monitorues i EULEX-it nuk mbulon monitorimin e kushteve të lirimit, dhe EULEX-i as nuk i ka kapacitetet për ta bërë këtë gjë. Pavarësisht se ku do të qëndrojë nëse lirohet, KRASNIQI ka mjetet dhe rrjetin për të realizuar secilin prej rreziqeve të parapara në nenin 41(6)(b).

39. Policia e Kosovës i ka ardhur në ndihmë ZPS-së kur i është kërkuar, sidomos gjatë arrestimeve të fundit të të akuzuarve. Por, ka arsye të vlefshme për të besuar se autoritetet kosovare kanë aftësi të kufizuara për të monitoruar një të akuzuar të profilit, burimeve dhe autoritetit si KRASNIQI, në një çështje si kjo.⁶⁴

⁶⁰ Kërkesa për lirim e KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/F00122, para. 19, 35.

⁶¹ Vendim mbi kërkesën për dorëzani, KSC-BC-2020-07/F00059, 27 tetor 2020, para.21. *Shih gjithashtu* Vendimi i apelit, KSC-BC-2020-07/IA001/F00005, para. 51.

⁶² *Shih në veçanti* nenet 4.2, 6-8 dhe 17 të Udhëzuesit të Punës të Zyrës Administrative në lidhje me të paraburgosurit – Vizitat dhe Komunikimet, KSC-BD-09/Rev1/2020, 23 shtator 2020.

⁶³ *Shih* Kërkesa për lirim e KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/F00122, para. 6.

⁶⁴ *Contra* Kërkesa për lirim e KRASNIQIT, KSC-BC-2020-06/F00122, para. 20, 35.

40. *Remzi SHALA*.⁶⁵ Kundër ish-komandantit të UÇK-së Remzi SHALA u ngrit një aktakuzë për krime lufte më 19 qershor 2016. Gjykimi filloi më 12 maj 2017. Gjatë pjesës së gjykit të SHALËS të zhvilluar në vitin 2018, atij iu miratua lirim i përkohshëm me kushtin që të paraqitej në gjykatë kur të thirrej. Seanca e fundit gjyqësore në vitin 2018 u mbajt më 16 nëntor 2018 dhe SHALA u lirua pas shtyrjes së gjykit me kushtin që të ishte i pranishëm në datën e planifikuar për vazhdimin e gjykit më 9 janar 2019. SHALA nuk u paraqit në gjykatë atë ditë, dhe as e informoi gjykatën për mungesën e planifikuar. Organet përgjegjëse vendore nuk qenë në gjendje ta arrestonin SHALËN, kështu që për të u lëshua një fletarrestim ndërkombëtar. SHALA u arrestua vetëm më 24 maj 2019, dhe nga ai moment e më tutje u mbajt në paraburgim.

41. *Sami LUSHTAKU*. Sami LUSHTAKU, ish-komandant i UÇK-së në zonën e Drenicës, u gjykua në çështjen *Drenica* bashkë me anëtarët e identifikuar me emër të NKP-së Sabit GECIN dhe Sylejman SELIMIN. Përpara fillimit të gjykit, LUSHTAKU po trajtohej në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë, në vend të paraburgimit.⁶⁶ Në maj të vitit 2014, ai dhe dy të paraburgosur të tjerë u arratisën nga spitali për një periudhë dyditore. Gjatë verës, pas vendimit të fajësisë në çështjen kryesore kundër LUSHTAKUT në vitin 2015, ai, Sylejman SELIMI dhe një tjetër nga personat që ishin shpallur fajtorë, përdorën arsye të rreme mjekësore për t'u vendosur në apartamente private brenda Qendrës Mjekësore të Prishtinës, për t'iu shmangur mbajtjes në paraburgim.⁶⁷ Më 21 gusht 2015, LUSHTAKU sërish u arratis nga spitali

⁶⁵ Humanitarian Law Center Kosovo, HLC Kosovo Annual Report 2019: War Crimes Trials—Still at the Beginning, 2020, f. 414; Humanitarian Law Center Kosovo, War Crimes: A discouraging Transition, 2019, f. 297; Humanitarian Law Center Kosovo, HLC Kosovo Annual Report 2017: War Crimes Trials – What Comes Next?, mars 2018, f. 402 (“HLC 2018 Report”).

⁶⁶ Humanitarian Law Center Kosovo, HLC Kosovo Report 2014: High-Profile Trials: Justice Delayed, 2014, f. 325.

⁶⁷ U.S. Department of State, “2015 Country Reports on Human Rights Practices – Kosovo, 13 prill 2016, gjendet në <https://www.refworld.org/docid/5716124d15.html>.

për disa orë, dhe shkoi në shtëpinë e tij në Prishtinë.⁶⁸ Më 22 shtator 2015, Policia e EULEX-it e arrestoi përsëri LUSHTAKUN pas arratisjes për herë të tretë nga paraburgimi. Kundër LUSHTAKUT dhe njëzet e tre personave të tjerë të përfshirë në këto tri arratisje u ngritën aktakuza. Në prill të vitit 2020, LUSHTAKU u shpall i pafajshëm në lidhje me arratisjen e majit të vitit 2014, ndërsa u shpall fajtor për të tjerat.

42. *Sabit GECI*. Edhe Sabit GECI mbahej i paraburgosur në një spital pas vendimit të fajësisë kundër tij në vitin 2011,⁶⁹ dhe në mënyrë të qartë kishte pushtet të madh mbi kushtet e burgimit të tij. [REDAKTUAR] zbulojnë se ai mund të vinte e të shkonte kur të dëshironte.⁷⁰ Në një bisedë veçanërisht treguese për të më 10 mars 2012, [REDAKTUAR] raportoi se GECI iu përgjigj si më poshtë pyetjes rreth sjelljes së rojeve të tij:

Mirë, shumë mirë ... paramendo një natë ishte një tjetër roje i ri dhe ai kishte frikë se mos po ikja prej dritares ... (duke e ofenduar rojën ngaqë kishte menduar kështu për S.G.-në) ... po të doja me të vërtetë të ikja mund ta bëja këtë kur të doja dhe mund t'i jepja urdhër edhe rojës të më shoqëronte, e vetëm ngaqë mendoi kështu për mua, dola për të ngrënë darkë këtu afër në [REDAKTUAR] dhe u ktheva pas katër orësh, e bëra qëllimisht ...⁷¹

43. Këto shembuj dukshëm demonstrojnë mungesën e kapaciteteve të Kosovës për të kryer arrestime ose për të monitoruar kushtet e ish-udhëheqësve të UÇK-së.

D. MASA SHITESË QË KËRKOHET ËSHTË E PANEVOJSHME

44. Lidhur me kërkesën e Mbrojtjes së KRASNIQIT për seancë dëgjimore, Gjykatësi i Procedurës Paraprake tashmë e ka bërë të qartë se ka informacion të

⁶⁸ HLC 2018 Report, f. 389.

⁶⁹ *Sabit Geci dhe të tjerët*, 45/2010, Aktgjykim, 29 korrik 2011.

⁷⁰ Shtojca 2.8 e Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Kërkesës në emër të z. Hashim Thaçi për lirim të përkohshëm, KSC-BC-2020-06/F00149/A02, 16 dhjetor 2020, konfidenciale.

⁷¹ [REDAKTUAR].

mjaftueshëm për të marrë vendim në lidhje me këtë kërkesë vetëm mbi bazën e parashtrimeve me shkrim.⁷²

III. KLASIFIKIMI

45. Ky parashtrim dorëzohet për protokollim si konfidencial, në pajtim me Rregullën 82(4). Do të dorëzohet për protokollim edhe një version i redaktuar publik.

IV. MASA E KËRKUAR

46. Për arsyet e lartpërmendura, kërkesa e parashtruar nga Mbrojtja e KRASNIQIT duhet të hidhet poshtë në tërësi.

Numri i fjalëve në origjinal: 4,738

_____/nënshkrimi/_____

Xhek Smith

Prokurori i Specializuar

E martë, 22 dhjetor 2020
Në Hagë, Holandë.

⁷² Vendim mbi kryerjen e rishikimit të paraburgimit dhe ndryshimin e afatit për mocionet paraprake, KSC-BC-2020-06/F00150, 16 dhjetor 2020.